




DEMOCRACYPLUS

Problemet (e shumta) në Prokurim Publik

Kamenicë, Podujevë, Fushë Kosovë, Shtime dhe Obiliq



Problemet (e shumta) në Prokurim Publik

Kamenicë, Podujevë, Fushë Kosovë, Shtime dhe Obiliq

E drejta e autorit © 2020. Demokraci Plus (D+)

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjete elektronik, mekanik, fotokopjohet apo të tjera, pa lejen e D+.

“Ky botim është prodhuar me përkrahjen e Bashkimit European. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Demokraci Plus dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i Bashkimit European apo të Lidërshtipit të Evropës Juglindore për Zhvillim dhe Integritet - SELDI”

Tabela e Përmbajtjes

Lista e Shkurtesave	3
Përmbledhje	4
Hyrje	5
Komuna e Kamenicës	6
Furnizim me dru 653-19-6263-1-2-1	6
Servisimi i auto mjeteve 653-19-5503-2-2-1	7
Komuna e Podujevës	8
Ndërtimi i shtigjeve me kubëza betoni për këmbësor ne Parkun e Qytetit dhe staza te shkolla e re në Batllavë 615-19-4707-5-2-1	9
Ndërtimi, rindërtimi dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik 615-19-6796-5-2-1	10
Komuna e Fushë Kosovës	11
Blerja e katër veturave zyrtare 612-19-6432-1-2-1	11
Furnizim me gjëra ushqimore dhe mjete sanitare 612-19-6057-1-2-1	12
Komuna e Shtimes	13
Vendosja e sistemit të kamerave në tërë qytetin e Shtimes 617-19-5785-1-2-1	13
Riparimi i dy urave dhe rregullimi i shtratit të lumit 617-19-5848-5-2-1	14
Komuna e Obiliqit	16
Furnizim me lëndë djegëse për ngrohje 614-19-6415-1-2-1	16
Sigurimi fizik i objektit komunal 614-19-149-2-2-1	17
Rekomandime	19

Lista e Shkurtesave

KRPP – Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik

OShP – Organi Shqyrtues i Prokurimit

RrUOPP – Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik

TVSh – Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Përmbledhje

Ky raport i monitorimit të aktiviteteve të prokurimit përshin 10 tenderë në pesë komuna, atë të Shtimes, Podujevës, Kamenicës, Obiliqit dhe Fushë Kosovës. Për secilën komunë janë monitoruar nga dy tenderë, duke filluar nga iniciimi i aktivitetit të prokurimit e deri në zbatimin e kontratës.

Nga ky monitorim, D+ ka identifikuar disa gjetje të cilat janë të përbashkëta për këto pesë komuna, por gjithashtu janë evidentuar edhe shkelje të cilat janë karakteristike e vetëm një komune. Disa prej gjetjeve kryesore të këtij raporti përfshijnë:

- **Mosplanifikimin e saktë të vlerës së parashikuar të tenderit.** Komuna e Kamenicëska paguar çmim shumë të lartë për një metër kub dru, krahasuar me kontratën evitit paraprak, si dhe atë të Komunës së Obiliqit. Si pasojë e vlerës së parashikuar qësishte shumë e lartë, komuna u ka mundësuar operatorëve ekonomik të ofertojnë çmime të larta, e rrjedhimisht edhe çmimi në kontratë është i lartë. Komuna e Fushë Kosovës gjithashtu nuk ka parashikuar saktë se sa kushton në treg një GolfVI i përdorur. E njëjta, për një veturë të tillë, e cila në treg kushton prej 9,000 deri në 10,000 euro, ka paguar 12,975 euro.
- **Dallimet ndërmjet titullit të tenderit dhe punëve të parapara në paramasë.** Një tenderi komunës së Shtimes ka titullin dhe përshkrimin "Riparimi i urave dhe shtratit tëlumit", megjithatë paramasa përmban vetëm elemente për rregullimin e urave.
- **Specifikat teknike të produkteve të kontraktuara nuk përputhen me ato që kërkoheshin në dosje të tenderit.** Në komunën e Shtimes janë kërkuar kamera që incizojnë videodhe audio, megjithatë kamerat që janë montuar mund të incizojnë vetëm video.
- **Problemet në llogaritje të shpenzimeve për tenderët e sigurimit fizik.** Komuna e Obiliqit nuk ka kalkuluar siç duhet shpenzimet që do të kishte një OE për të gjitha obligimet që dalin nga Ligji i Punës. Si rezultat, komuna ka lidhur kontratë me të cilinçmim nuk i mbulon të gjitha shpenzimet.
- **Kërkesat e paqarta në kriteret e dosjes së tenderit.** Në disa komuna ka kritere që janë të paqarta dhe nuk janë të definuara saktë. Këtu përfshihen kërkesat për mjete të transportit pa specifikuar peshën e tyre, kërkesa për hapësirë të ruajtjes së druve paspecifikuar sipërfaqen e saj.
- **Mospecifikimin e kushteve të veçanta në momentin kur publikohet dosja e tenderit,** gjë e cila bëhet vetëm pasi të nënshkruhet kontrata.

Hyrje

Prokurimi publik në Kosovë ka përmirësime të vazhdueshme çdo vit, sidomos tani që platforma e e-Prokurimit gjithnjë e më shumë po avancohet. Megjithatë, në pjesët ku ende ka nevojë për faktorin njeri, vërehen çalime. Shkeljet e vazhdueshme të ligjit nga zyrtarët e prokurimit dhe ndëshkimet e pakta po shkaktojnë një situatë ku nuk po arrihet qëllimi i Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), pra që të ketë prokurim efikas.

Zakonisht janë vetë kompanitë që kanë ofertuar në një tender të cilat ekspozojnë shkeljet, së pari duke u ankuar te autoriteti kontraktues, e pastaj nëse nuk janë të kënaqura me vendimin, në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP). Mirëpo, nëse nuk vërehet ndonjë shkelje atëherë janë organizatat joqeveritare të cilat ekspozojnë shkeljet e ligjit.

Në këtë raport janë monitoruar nga dy tenderë për çdo komunë, atë të Kamenicës, Podujevës, Fushë Kosovës, Shtimes dhe Obiliqit. Këto janë komuna më të vogla krahasuar me disa komuna tjera në Kosovë, andaj edhe fokusi i organizatave joqeveritare nuk kanë qenë shumë i madh. Nga ana tjetër, përzgjedhja e tenderëve është bërë duke kombinuar rrezikun në fusha të caktuara, siç janë tenderët për sigurim fizik, ndërtim të rrugëve, servisim të automjeteve, me vlerën e parashikuar të tenderit. Në raport janë të analizuara të gjithë hapat e procesit të prokurimit duke filluar që nga inicimi i aktivitetit të prokurimit, dosja e tenderit dhe kriteret e saj, pranimi i ofertave dhe përzgjedhja e fituesit e deri te zbatimi i kontratës. Dokumentet janë marrë nga platforma e e-Prokurimit, ndërsa të tjerat që nuk gjenden në platformë janë siguruar përmes kërkesave për qasje në dokumente publike.

Demokrati Plus angazhohet që përmes monitorimit të vazhdueshëm të aktiviteteve të prokurimit të nxjerr në pah shkeljet e ligjit dhe të ekspozojë korrupsionin potencial. Në anën tjetër, gjetjet dhe rekomandimet ofrojnë pikë referimi për zyrtarët e prokurimit ashtu që t'i evitojnë shkeljet e dispozitave ligjore në të ardhmen.

Komuna e Kamenicës

Një nga dy tenderët e monitoruar në Komunën e Kamenicës, është ai për furnizim me dru. Përcaktimi jo i duhur i vlerës së parashikuar të tenderit u ka mundësuar kompanive që të ofrojnë çmime më të larta sesa kontrata e njëjtë e vitit paraprak. Përveç kësaj, këto çmime kanë qenë më të larta se në disa komuna tjera, e atë për sasi të ngjashme të druve dhe lloj të njëjtë të tyre.

Tenderi tjetër i monitoruar është për servisim të automjeteve të komunës. Në të dy llojet, të dy kompanitë fituese kanë çmime shumë të larta në disa produkte e shumë të ulëta në disa të tjera. Komuna si duket, fare nuk i ka krahasuar këto çmime me ato të tregut, madje kompanitë e parashikojnë edhe se cilat pjesë të veturave prishen zakonisht, për të dhënë çmime më të larta pikërisht për këto pjesë.

Në të dy tenderët ka disa kërkesa të paqarta në dosje të tenderit, mosspecifikimi i saktë i sipërfaqeve të hapësirave të punës dhe i mjeteve të punës.

Furnizim me dru 653-19-6263-1-2-1

Tenderi për furnizim me dru ka qenë i ndarë në dy lloje, njëri për furnizim me dru për institucionet arsimore, ndërsa tjetri për furnizim me dru për qendrat e mjekësisë familjare dhe institucionet tjera komunale. Fitues i kontratës për të dy llojet ishte zgjedhur kompania NTP Mali, me çmim 81,400 euro për llot 1 dhe 25,434 euro për llot 2. Për llotin e parë kishte edhe një ofertë tjetër, e cila ishte me çmim më të lartë, ndërsa për llotin e dytë kishte edhe tri oferta të tjera, njëra me çmim më të lartë dhe dy oferta të tjera të papërgjegjshme, por me çmim më të ulët se NTP Mali. Kompania Aome ishte eliminuar pasi pajisjet e ofruara nuk përputheshin me librezat e qarkullimit, ndërsa kompania tjetër, Çlirim Berisha B.I. kishte dorëzuar dy lista të çmimeve. Nga këto të dhëna, mund të thuhet që eliminimi i tyre është i bazuar në LPP dhe RrUOPP.

Koha kur iniciohen tenderët për dru është pjesa më e rëndësishme e këtyre tenderëve. Druri është një produkt, çmimi i të cilit varet kryesisht në cilin sezon jemi, me çrast është e rëndësishme që aktiviteti i prokurimit të iniciohet në periudhën pranverë-verë, kur çmimi i një metri kub dru është më së liri. Mirëpo, një gjë të tillë nuk e ka bërë Komuna e Kamenicës, pasi tenderi është publikuar në fund të verës, më saktë kompanitë i kanë dorëzuar ofertat e tyre më 11 shtator të vitit 2019.

Vlera e parashikuar e tenderit kishte qenë 112,608.50 euro, por nuk ka qenë e dhënë për secilin llot. Në llotin 1 janë kërkuar dru ahu në sasi 1,850 m³, ndërsa në llotin 2, dru ahu 261 m³ dhe dru bungu 300 m³. Sasia e përgjithshme për të dy llojet ka qenë 2411 m³. Po të pjesëtohet ky numër me vlerën e parashikuar, atëherë nxirret vlera e parashikuar për një metër kub dru (edhe pse janë të kombinuar dru ahu dhe bungu, ahu përbën 87.5% të sasisë), e cila është 46.7 euro.

Për tender të njëjtë, por i qershorit të vitit 2018, komuna për llotin 1, që përfshinte 1,800 m³ dru ahu kishte parashikuar vlerën 78,624 euro, apo për një metër kub 43.7 euro. Kjo vlerë siç shihet është për tri euro më e ulët se në tenderin e vitit 2019. Komuna nuk ka parashikuar siç duhet vlerën e tenderit dhe u ka mundësuar kështu kompanive që të ofertojnë me çmime më të larta. Në tenderin e vitit 2019, çmimi i ofruar për llot 1 nga NTP Mali ishte 44 euro, ndërsa në vitin 2018, kontrata ishte lidhur me NT Pylla me çmim prej 43.5 euro për m³.

Për llot 2, çmimi i dhënë nga NTP Mali në tenderin e vitit 2019 ishte 44 euro për dru ahu dhe 46.5 euro për dru bungu apo qarri. Ndërkaq, në atë të vitit 2018, çmimi i ofruar nga NT Pylla ishte 45.5 euro për dru qarri ose bungu. Nga të dhënat më lartë vërehet se kontrata e lidhur në vitin 2019 për llot 1 është për 0.5 euro më e lartë për një metër kub dru ahu apo gjithsej 1,055.50 euro ($2,111 \text{ m}^3 * 0.5$) krahasuar me çmimet e kontratës së vitit 2018.

Për llot 2 dallimi është më i madh, kontrata e vitit 2019 është më lartë për një euro për metër kub apo gjithsej 300 euro më shumë ($300 \text{ m}^3 * 1$) se ajo e vitit 2018. Gabimi i komunës në tenderin e vitit 2019 është që nuk e ka dhënë vlerën e parashikuar për secilin llot. Në atë rast do të dihej se sa është kufiri i buxhetit dhe kompanitë do të ofertonin nën çmimin e dhënë.

Në Kosovë ka komuna të tjera që i blejnë drutë më lirë se Komuna e Kamenicës. Komuna e Obiliqit, në tetor të vitit 2019 ka blerë dru me çmim 31.7 euro, ku edhe në atë tender janë kërkuar dru ahu me sasi të përafërt, duke përfshirë edhe prerjen e tyre ($2,111 \text{ m}^3$ në Kamenicë, 1960 m^3 në Obiliq). Përcaktimi i saktë i vlerës së parashikuar të tenderit është një nga hapat e parë para se të publikohet një tender. Këtij hapi duhet t'i kushtohet shumë vëmendje, pasi një parashikim i fryrë i çmimit të një produkti bën që të paguhet më shumë sesa që duhet. Një shembull të tillë e kemi rastin e Komunës së Kamenicës, ku ka paguar për 39% më shumë se Komuna e Obiliqit.

Komuna, për llot 1 në dosje të tenderit ka kërkuar si kriter që kompanitë të kenë paraprakisht në depot e tyre 500 m^3 dru dhe 85 m^3 ahu ose 100 m^3 dru bungu për llotin 2. Ky është një kriter kufizues dhe ngarkon kompanitë në mënyrë të panevojshme, pasi ruajtja dhe mbajtja e produkteve ka kosto financiare. Zakonisht në tenderët për furnizime nuk kërkohet nga ofertuesit që paraprakisht të kenë në depot e tyre një sasi të caktuar të produkteve. Në këtë rast komuna nuk është dashur që ta vendosë një kërkesë të tillë, pasi i eliminon kompanitë që nuk e kanë sasinë e kërkuar në momentin e ofertimit si dhe kompanive jofituese ju mbeten drutë e pashitura për një periudhë të caktuar.

Servisimi i automjeteve 653-19-5503-2-2-1

Tenderët për servisim të automjeteve janë gjithmonë problematik, për shkak të paramasës shumë të voluminoze dhe çmimeve jo normalisht të ulëta dhe të larta që ofrojnë kompanitë. I tillë është edhe tenderi i Komunës së Kamenicës, i ndarë në dy lloje, ku fillimisht fitues për llot 1 ishte D.P.Z. Behari, ndërsa llot 2 ishte anuluar. Mirëpo, kundër këtij vendimi, D.P.Z. Astriti ishte ankuar në OShP. Pretendimi ishte se komuna për pozicionet që nuk i kishte plotësuar as D.P.Z. Behari ishte eliminuar vetëm D.P.Z. Astriti. Nga OShP kjo ishte cilësuar si trajtim i pabarabartë, ku kishte vendosur që tenderi të kthehet në rivlerësim¹. Pas rivlerësimit, komuna kishte përmirësuar gabimin duke shpallur fitues për llot 1, D.P.Z. Astritin dhe për llot 2, D.P.Z. Erdionin. Në këtë tender është përdorur procedura e kontratës kornizë me poentim, e cila shërben vetëm për të zgjedhur fituesin e tenderit, mirëpo kontrata lidhet me çmime për njësi, ndërsa vlera e parashikuar shërben si tavan, i cili mund të devijohet për +30%. Janë dy probleme që mund të paraqiten gjatë kësaj procedure, nuk mund të aplikohet kriteri për çmim jonormalisht të ulët si pasojë e poentimit, ndërsa problemi tjetër janë edhe çmimet e larta. Veturat zakonisht bëjnë së paku një herë një vit servisimin e rregullt, i cili përfshin ndërrimin e vajit dhe filterave të vajit, naftës, ajrit dhe klimës. Në të dy llotet, të dy kompanitë kanë çmime pak më të larta se të tregut. Për veturat në llot 1, një servisim i rregullt me katër litra vaj 10/40, si dhe të gjithë filterët do t'i kushton komunës 151 euro, ndërsa në treg ka servisim të plotë me më pak se 100 euro.

¹ Vendimi 656/19. Organi Shqyrtues i Prokurimit. 2019.

<http://arkivaoshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2019/656-19vendim.pdf>

Në pozicionet tjera të paramasës për të dy llotet ka çmime të cilat në treg janë më të lira si dhe e kundërta. Shembull, në llot 1, larja e veturave është ofruar për katër euro, ndërsa në treg kushton tri euro. Dallime të mëdha në çmime ka në disa pozicione të të dy lloteve: në llot 1, xhami i derës së parë dhe derës së pasme kanë çmim një euro, mirëpo në llotin 2, kompania tjetër ka dhënë çmim prej 55 dhe 35 euro respektivisht.

Komuna si duket fare nuk është marrë me krahasimin e çmimeve jonormalisht të ulëta në shumë pozicione dhe si rezultat gjatë implementimit të kontratës është rreziku që vetëm pjesët ku është dhënë çmimi i tregut ose më i lartë të faturohen. Një dukuri të tillë, D+ e ka zbuluar në Komunën e Gjakovës, ku të gjitha riparimet në automjete çuditërisht ishin bërë vetëm për pjesët në të cilat fituesi i kontratës kishte dhënë çmime të larta².

Kriteri i dosjes së tenderit që lokacioni i autoservisit të jetë në territorin e Komunës së Kamenicës është kufizues ndaj konkurrencës, pasi ka shumë fshatra që janë të komunave tjera dhe që janë afër qytetit të Kamenicës. Komuna në dosje të tenderit nuk e ka cekur fare se a i dërgon vetë veturat që janë në gjendje të voziten deri te autoservisi, si dhe kush i dërgon në servis ato që janë me defekte. Këtë gjë, komuna do të duhej ta përcaktonte në dosjen e tenderit në mënyrë që të mos ketë mosmarrëveshje gjatë zbatimit të kontratës. Një kërkesë tjetër e paqartë është ajo që ofertuesi të posedojë hapësirë adekuatë për servisimin e automjeteve. Në këtë kërkesë nuk është specifikuar se sa duhet të jetë sipërfaqja e kësaj hapësirë. Komuna në këtë rast është dashur të përcaktojë dimensionet apo sipërfaqen që kërkon të hapësira për kryerje të punëve dhe më këtë rast shmang mosmarrëveshjet potenciale që do të mund të lindnin në të ardhmen.

Disa nga kushtet e veçanta janë përcaktuar në dosje të tenderit, mirëpo elementi më i rëndësishëm, garancioni, nuk është përcaktuar në dosje të tenderit por në kontratë, e atë për një periudhë prej një viti. Një OE duhet ta dijë paraprakisht se sa do të kërkohet garancionit, në mënyrë që ta përgatisin ofertën e tyre duke përfshirë edhe koston e garancionit, e cila rritet nëse koha e garancionit zgjatet dhe anasjelltas.

Paramasa e këtij tenderi, e cila është punuar në formatin Excel ka disa gabime në disa fusha. Në llotin 1, në kolonën S është produkti "Gjenerator 95 KW-Wolwo-margen Maranella", i cili nuk është përfshirë në llogaritjen në formulën e paraqitur në kolonën T (formula mbledhë të gjithë numrat nga kolona E deri te R). Megjithatë, në kontratë çmimi i paraqitur në kolonën T, përfshin edhe çmimin në kolonën S. Dyshimi në këtë rast është ndërhyrja në paramasë nga kompania fituese.

Komuna e Podujevës

Në Komunën e Podujevës janë monitoruar dy tenderë që kanë të bëjnë me kryerje të punëve. Kriteret e dosjes së tenderit për të dy aktivitetet janë në disa raste të paqarta dhe me mangësi të shumta, e cila mund të hapë rrugë për mosmarrëveshje mes operatorëve ekonomik dhe komunës. Problem tjetër mbetet mospublikimi i kontratave me të gjitha elementet e saj, veçanërisht mungesa e pjesës financiare në kontratat e publikuara, me ç'rast ua pamundëson qytetarëve dhe palëve tjera të interesit të shohin se me çfarë çmime kanë ofertuar kompanitë në tender.

² Drejt komunave me prokurim publik të hapur, llogaridhënës dhe efikas. Faqe 41. Demokraci Plus. 2018. <http://dplus.org/wp-content/uploads/2018/12/2018-12-03-Drejt-komunave-me-prokurim-t%C3%AB-hapur-llogaridh%C3%ABn%C3%ABs-dhe-efikas-ALB-Final-1.pdf>

Problem tjetër është se, komuna nuk i specifikon kushtet e veçanta të dosjes së tenderit në kohën kur e publikon njoftimin për kontratë, por këto kushte bëhen pjesë e kontratës pasi të nënshkruhet ajo.

Me fjalë të tjera, kompanitë që ofertojnë në tender duhet ta dinë para se të ofertojnë se çfarë kushte ka vendosur komuna.

Ndërtimi i shtigjeve me kubëza betoni për këmbësor në Parkun e Qytetit dhe staza të shkolla e re në Batllavë 615-19-4707-5-2-1

Në këtë tender kishin ofertuar katër kompani, ndërsa fitues ishte përzgjedhur kompania Vllëzerit Hyseni me çmim 25,167.20 euro, i cili ishte gjithashtu çmimi më i lirë. Dy kompani tjera ishin cilësuar të papërgjegjshme pasi kishin pasur mungesë të disa dokumenteve, ndërsa një kompani tjetër ishte e përgjegjshme, por për shkak të çmimit më të lartë nuk ishte shpallur fituese.

Ky aktiviteti i prokurimit nuk është në planin e prokurimit për vitin 2019, edhe pse në Deklaratën e Nevojave është cekur se është përfshirë në këtë plan. Vetëm dy tenderë janë në plan të prokurimit për realizim të punëve në Batllavë, por asnjëri prej tyre nuk është për ndërtim me kubëza betoni.

Disa nga kriteret e dosjes së tenderit janë kufizuese ndaj konkurrencës si dhe të paqarta. Kërkesa për 15 punëtorë bie ndesh me RrUOPP, i cili thotë se duhet të kërkohet një mesatare e fuqisë punëtore për tri vitet e fundit duke u llogaritur nga njoftimi për kontratë³. Një shembull i tillë do të ishte kërkesa që ofertuesi të ketë një mesatare të fuqisë prej 15 punëtorëve në tri vitet fundit nga data e njoftimit për kontratë. Kërkesa e AK ka mundur ta kufizojë konkurrencën, por komuna kufizimin në numër të punëtorëve e ka zgjidhur duke i shtuar edhe fjalinë që OE të ofrojë dëshmi se mund të angazhojë staf të mjaftueshëm. Një kërkesë e paqartë është ajo për mjetet e punës. Komuna kërkesën e ka formuluar vetëm për mjetet e domosdoshme të punës, mjete këto që nevojiten për realizimin e punimeve, por nuk ka specifikuar se cilat mjete duhen. Kjo i ka dhënë mundësi OE-ve të caktojnë vetë se cilat janë mjetet e domosdoshme dhe interpretimi sigurisht nuk do të ishte i njëjtë të të gjitha OE-të. Kjo kërkesë e paqartë mund të krijojë mosmarrëveshje gjatë realizimit të punëve ndërmjet kompanisë fituese dhe komunës, për shkak se nuk dihet se me cilat pajisje do ta kryejë punën kompania.

Kushtet e veçanta të dosjes së tenderit nuk janë cekur kur është publikuar njoftimi për kontratë. Siç është cekur më lartë, garancioni është elementi kryesor i kushteve të veçanta, i cili nëse nuk përcaktohet që në fillim, ndikon në ofertat e kompanive, përveç nëse ato kanë informacion se çfarë garancioni do të kërkohet për fituesin e kontratës.

Pasi ky tender është për ndërtimin e rrugëve me kubëza, në specifikimin teknik përfshihet sipërfaqja që do të shtrohet me kubëza, materiali i kubëzave, trashësia dhe elementet tjera. Sipërfaqja e paraparë për t'u shtruar me kubëza përputhet me dimensionet e dhëna në paramasë.

3 Neni 26.8, faqe 61. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik. KRPP. 2019
[https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/A01 2019/Rregullat dhe Udhëzuesi 10 04 2019 2.pdf](https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/A01%202019/Rregullat%20dhe%20Udhëzuesi%2010%2004%202019%202.pdf)

Sipas gjetjeve të D+, të cilat janë paraqitur në raportin “Niveli i publikimit të kontratave në prokurim publik”⁴, Komuna e Podujevës nuk e publikon pjesën financiare të kontratës, gjë që e bën më të vështirë analizimin e të dhënave. Sipas RrUOPP, kontrata duhet të publikohet në e-Prokurim dhe duhet të përfshijë kontratën, kushtet e përgjithshme, kushtet e veçanta dhe përshkrimin e çmimeve. Kjo është një shkelje e përsëritur e komunës në pothuajse të gjitha kontratat që i publikon.

Ndërtimi, rindërtimi dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik 615-19-6796-5-2-1

Tenderi për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik është publikuar më 10 shtator 2019, me vlerë të parashikuar prej 98,418.18 euro. Ky tender në fakt ishte ritenderim, pasi tenderi i parë ishte anuluar për shkak të problemeve teknike me platformën e-Prokurimi. Në tenderin e dytë ofertuan gjashtë kompani, ndërsa fitues u zgjodh konzorciumi ABC & Elektro Meli & Graniti me çmim 51,007.50 euro. Ishte edhe një ofertë më e lirë se fituesi, por e papërgjegjshme për shkak të mungesës së menaxherit të projektit i cili ishte kërkuar të jetë inxhinier i diplomuar ose master i elektroteknikës – drejtimi i energjetikës. E papërgjegjshme ishte edhe një kompani tjetër që kishte çmimin më të lartë, ndërsa tri të tjera ishin të papërgjegjshme, por me çmim më të ulët se fituesi. Për shkak se tenderi i parë ishte anuluar për shkak të problemeve teknike, komuna nuk është dashur që të publikojë raportin për hapjen e tenderëve⁵, pasi kjo ua ka mundësuar ofertuesve që të shohin çmimet e njëri-tjetrit dhe të bazohen në to për të ofertuar në tenderin e dytë. Siç duket kështu edhe ka ndodhur, pasi konzorciumi fitues e ka ulur ofertën e tij për rreth tetë mijë euro krahasuar me ofertën e parë.

Komuna kishte shkurtuar afatin për pranimin e ofertave në tenderin e dytë nga 20 ditë në 10 ditë, me arsyen që ka defekte të mëdha në terren, por në fakt arsyeja do të duhej të ishte për shkak të problemeve teknike në e-Prokurim. Në kriteret e dosjes së tenderit, një praktikë e mirë është se për kërkesën rreth “projekteve të realizuara në tri vitet e fundit në vlerë 140,000 euro”, udhëheqësi i konzorciumit duhet ta ketë së paku 60% të shumës së kërkuar. Kjo kërkesë e pamundëson që të krijohen konzorciume në mes kompanive që kanë shumë pak punë të kryera në fusha të ngjashme, siç është kjo për ndriçim publik. Si në tenderin për shtrim të kubëzave, edhe në këtë tender është kërkuar numri fiks i punëtorëve e jo siç e kërkon RrUOPP që të kërkohej një mesatare e fuqisë punëtore për tri vitet e fundit. Për më tepër, nuk janë kërkuar kontrata për punëtorët e thjeshtë, e cila mund ta sjellë situatën ku një punëtor të deklarojë që pa dijeninë e tij është futur në listë të kompanisë. Kjo ka ndodhur në disa raste që D+ ka hasur gjatë monitorimit të OShP-së. Pajisja e vetme e kërkuar është një autokorpë (shportë) për intervenim në lartësi të ndryshme. Autokorpa është një pajisje që i ngrit lart punëtorët për të intervenuar nëpër shtylla elektrike. Në këtë rast nuk është specifikuar lartësia se sa nevojitet që të ngritet lart, pasi jo të gjitha autokorpat mund të ngritën në lartësi të njëjtë.

Kushtet e veçanta të dosjes së tenderit nuk janë cekur kur është publikuar njoftimit për kontratë, por janë përfshirë në kontratë pasi është zgjedhur fituesi. E çuditshme është se komuna nuk ka kërkuar periudhë të garancionit edhe në kushtet e veçanta që janë pjesë e kontratës. Pasi ky tender ka të bëjë me ekzekutim të punëve, garancioni duhet patjetër të kërkohej.

⁴ Niveli i publikimit të kontratave në prokurim publik. Demokraci Plus. 2020.

<http://dplus.org/wp-content/uploads/2020/01/2020-01-31-Niveli-i-publikimit-te-kontratave-ne-Prokurim-Publik.pdf>

⁵ Raporti i hapjes së tenderëve. E-Prokurimi.

https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaci-Frm.aspx?id=609883

Ky aktivitet i prokurimit ka qenë në planin e prokurimit për vitin 2019, me vlerë të parashikuar 150,000 euro, ndërsa vlera e parashikuar në njoftimin për kontratë shumë më e ulët, 98,418.18 euro. Kjo shumë është e njëjtë edhe në Deklaratën e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve. Nga dy vlerat më lartë mund të vërehet që komuna nuk e ka planifikuar si duhet se sa mjete do të shpenzohen për këtë tender. Në plan të prokurimit, aktiviteti është paraparë që të fillojë në prill të vitit 2019, por ka filluar në shtator të të njëjtit vit, pra me një vonesë prej katër muajve.

Sikur për tenderin për shtrim të kubëzave, edhe për këtë tender nuk është publikuar pjesa financiare e kontratës. Si duket komuna nuk e përfshin fare pjesën financiare në kontratë, pasi edhe në dokumentet që na ka dërguar mungon kjo pjesë, e gjithashtu mungon në kontratën e publikuar në e-Prokurim si dhe në ueb-faqe të komunës.

Komuna e Fushë Kosovës

Në Komunën e Fushë Kosovës janë monitoruar dy tenderë, njëri për blerje të veturave dhe tjetri për furnizim me gjëra ushqimore dhe mjete sanitare. Komuna nuk na ka dhënë qasje në dokumente publike, megjithatë D+ është shërbyer nga dokumentet që gjenden në e-Prokurim.

Tenderi për blerje të veturave ka qenë i përshtatur për blerje të veturave Golf VI, ndërsa gjithashtu komuna nuk ka parashikuar saktë çmimin për një veturë duke bërë që të paguajë 12,975 euro për një veturë e cila në treg kushton 9,000 deri 10,000 euro. Komuna në këtë rast i ka shkaktuar humbje buxhetit të saj prej 4,700 deri 9,420 euro në total.

Në tenderin për furnizim me gjëra ushqimore dhe mjete sanitare ka gabime të shumta duke përfshirë njësitë matëse të gabuara, përshkrim të mangët të produkteve dhe disa produkte të identifikuar me emrin e një prodhuesi të caktuar.

Blerja e katër veturave zyrtare 612-19-6432-1-2-1

Tenderi për blerjen e katër veturave njëherë ishte anuluar për shkak të mungesës së ofertave. Në tenderin e dytë vlera e parashikuar ishte rritur nga 50,000 në 53,500 euro, në të cilin kishte ofertuar vetëm një kompani, Dretni-A, të cilës iu dha kontrata me çmim 51,900 euro. I vetmi dallim në specifika teknike në mes të dy tenderëve, është se në të parin ishin kërkuar vetura me minimum vitin e prodhimit 2012, ndërsa në tenderin e dytë ishte ndryshuar me minimum vitin e prodhimit 2011. Sa i përket kriterëve të dosjes së tenderit, në fakt komuna ka rritur kriterin për referencë për furnizime të ngjashme në tri vitet e fundit nga 75,000 euro në 80,250 euro. Pasi nuk ka pasur oferta në tenderin e parë, në fakt kriteret do duhej të uleshin e jo të rriten. Komuna gjithashtu ka shkurtuar afatin kohor për pranimin e ofertave me arsyen se është ritender. Shkurtimi i afatit kohor për të ofertuar nuk mund të ndodhë për arsye të veprimeve të komunës, por vetëm për shkak të fuqisë madhore, shembull ndonjë fatkeqësi natyrore. Gjetje tjetër është se komuna nuk e ka planifikuar blerjen e veturave, meqë ky aktivitet nuk kishte qenë në planin e prokurimit të vitit 2019⁶.

⁶ Planifikimi i Prokurimit për vitin 2019. Komuna e Fushë Kosovës.

https://kk.rks-gov.net/fushekosove/wp-content/uploads/sites/16/2019/02/Planifikimi-i-prokurimit-per-vitin-2019_1.pdf

Specifikimi teknik i hartuar është përshtatur për një markë të veturave, Volkswagen Golf VI, ku përveç që përputhen specifikat teknike që gjenden në broshurat në uebfaqen e Volkswagen, gjithashtu edhe emërtimi i dokumentit të specifikacionit teknik është “Specifikimet Golf 6 fks__2011 (3)”. Përshtatje e kriterëve për një markë apo kompani të caktuar është e ndaluar me LPP-në dhe në këtë rast komuna ka kufizuar konkurrencën. Përshtatjen e kriterëve komuna e ka bërë me gabime në disa vende. P.sh: ka kërkuar që vetura të ketë nivelin Euro 6 të liritimit të gazrave, ndërsa ky kriter është në fuqi nga viti 2015, ndërsa Golf VI është prodhuar vetëm deri në vitin 2014.

Pra kompania nuk mund të ofrojë Golf VI me Euro 6 standard, çka nënkupton që nuk do të mund t’i përmbahet specifikave teknik të kërkuar në dosje të tenderit.

Komuna ka kërkuar që t’i blejë katër vetura, ndërsa nga çmimi i kontraktuar prej 51,900 del që për një veturë Dreni-A ka dhënë çmim prej 12,975 euro. Komuna ka kërkuar veturë me kapacitet të motorit 2.0, të jetë manual ose automatik si dhe me pajisje tjera standarde. Në bazë të këtyre kriterëve, në treg çmimi varion nga 9,000 deri 10,000 euro, ndërsa kur shtohet edhe TVSh-ja prej 18%, atëherë çmimi do të ishte nga 10,620 deri në 11,800 euro. Në rastin më të mirë komuna ka paguar për një veturë 1,175 euro më shumë se çmimi i tregut përfshirë TVSh-në, e në rastin më të keq ka paguar rreth 2,355 euro për një veturë, ndërsa në total ka paguar më shumë 4,700 deri 9,420 euro.

Sipas kësaj matematike, është dëmtuar buxheti i komunës. Para publikimit të tenderit, komuna është dashur që të bëjë një hulumtim më të mirë të tregut, për të parë se sa kushton një veturë e tillë në treg e pastaj të fillojë aktivitetin e prokurimit.

Furnizim me gjëra ushqimore dhe mjete sanitare 612-19-6057-1-2-1

Në tenderin për furnizim me gjëra ushqimore dhe mjete sanitare kishin ofertuar dy kompani, ndërsa me kontratë ishte shpërblyer kompania EE Eximi me çmim 56,076.26 euro, i cili ishte edhe çmimi më i ulët. Vlera e parashikuar ishte 120,000 euro, pra më shumë se dyfishi i ofertës nga EE Eximi. Për shkak të dallimit të madh dhe llojeve të ndryshme të produkteve që janë kërkuar është vështirë të përcaktohet se a ka keqplanifikuar komuna apo EE Eximi ka dhënë çmime jonormalisht të ulëta. Nga analizimi i kontratës janë disa pozicione ku EE Exim ka ofruar çmime shumë të ulëta:

- Tetë cent për një kilogram biber të zi – në treg rreth 10 cent kushton një paketim i vogël që ka rreth 10 gram;
- Një euro për një kilogram brokoli – në treg një copë brokoli që ka rreth 300 gram kushton rreth tri euro;
- 0.47 euro për një kilogram kikirika – në treg një kilogram kushton rreth pesë euro.

Nga 158 produkte të kërkuara, ka disa prej tyre që njësinë matëse nuk e kanë të duhur:

- Magdanozi është kërkuar me kilogram ndërsa në treg ky produkt matet me copë;
- Biberi i kuq dhe i zi gjithashtu janë kërkuar me kilogram, ndërsa në treg paketimet janë më të vogla dhe maten me gram.

Shumë produkte nuk janë të specifikuar siç duhet, gjë e cila i jep mundësi kompanisë të dërgojë produktet më të lira. Disa prej tyre janë:

- Në pozicionin 62 të paramasës është kërkuar leckë nga lëkura e kualitetit të lartë, por është specifikuar se si definohet kualiteti i lartë;
- Në pozicionin 133 është kërkuar “torte 100 gr.”, por nuk është specifikuar se çfarë lloj torte.

Gabimet në njësi matëse së bashku me mospërshkrim të duhur të produkteve i ka mundësuar kompanisë që të vendosë çmime të ulëta në shumë pozicione, të cilat janë reflektuar në çmimin total të kontratës.

Në paramasë ka shumë produkte të cilat e kanë të paracaktuar emrin e markës apo të kompanisë prodhuese. Kjo në parim është e ndaluar me LPP, por komuna për secilin produkt ku përmendet marka ka shtuar edhe fjalën “ekuivalent”, çka ka bërë që mos të shkelet ligji. Mirëpo, duhet thënë se komuna është dashur që t’i hartojë specifikat pa përmendur marka të caktuara.

Komuna e Shtimes

Në Komunën e Shtimes janë monitoruar dy tenderë, njëri për instalim të kamerave në qytet dhe tjetri për ndërtimin e dy urave në qytet. Tenderi për instalimin e kamerave ka shkelje të shumta, në specifika teknike ishin kërkuar kamera që mund të incizojnë edhe zërin, por kompania fituese kishte ofruar kamera që mund të incizojnë vetëm videon. Gjithashtu, disa nga specifikat e shumta të kërkuara nuk përputhen me modelin e kamerave të ofruara nga operatori ekonomik.

Tenderi për riparimin e urave dhe rregullimin e shtratit të lumit ka mangësi pasi nuk është ofruar projekti ekzekutiv së bashku me dosjen e tenderit. Titulli dhe përshkrimi i tenderit nuk përputhen me pozicionet e paramasës, të cilat përfshijnë vetëm riparimin e dy urave por jo edhe rregullimin e shtratit të lumit.

Vendosja e sistemit të kamerave në tërë qytetin e Shtimes 617-19-5785-1-2-1

Tenderi për vendosjen e kamerave në qytetin e Shtimes ishte publikuar në gusht të vitit 2019, me vlerë të parashikuar prej 35,000 euro. Tenderi ishte i llojit të kontratës kornizë me afat të përfundimit të punëve deri në fund të majit 2020. Pesë kompani kishin ofertuar për këtë tender, ndërsa fitues ishte përzgjedhur kompania AFAIng me çmimin më të ulët, 23,333 euro. Të gjitha kompanitë tjera u cilësuan si të përgjegjshme, ndoshta pasi edhe kriteret që ishin në dosje të tenderit ishin të arritshme. Vlerësimi i ofertave është bërë sipas ligjit dhe brenda afatit kohor prej 30 ditësh.

Problemi më i madh në prokurimin publik në Kosovë qëndron në specifikat teknike. Në produktet e teknologjisë informative nuk ka shume terma në gjuhën shqipe, dhe zakonisht specifikat teknike kopjohen nga ndonjë faqe në internet, të cilat janë në gjuhën angleze. Në rastin e këtij tenderi, specifikat teknike janë shumë të detajuara, e madje edhe në këtë rast dyshimi është që ato janë kopjuar nga specifikat e ndonjë produkti. AFA Ing ka ofruar modelin e kamerës DS-2CD2T43G0-I5⁷ të prodhuesit Hikvision, mirëpo disa nga specifikat e këtij modeli nuk përputhen me ato të kërkuar në dosje të tenderit. Në tabelën e mëposhtme shfaqen dallimet në specifika.

⁷ Faqja e modelit të kamerës DS-2CD2T43G0-I5/I8 nga Hikvision

<https://www.hikvision.com/es-la/Products/Network-Camera/EasyIP-2.0plus/4MP/DS-2CD2T43G0-I5/I8>

	Specifikat në dosje të tenderit	Specifikat e kamerës DS-2CD2T43G0-I5
1	IR distanca min. 100m	IR distanca deri në 50 metra
2	Kompresimi i audios duhet të përkrah G.711a/ G.711Mu/ AAC/ G.726	Nuk ofron incizim të zërit, vetëm video

Tabela 1. Dallimi në mes të specifikave të kërkuara për kamerë dhe atyre të ofruar nga kompania fituese.

Në pikën e parë IR distanca nënkupton se sa larg mund të arrijë të xhirojë natën kamera. Nga tabela shihet që kamera e ofruar arrin vetëm gjysmën e distancës krahasuar me atë të kërkuar. Në pikën dy është mangësia më e madhe, kamerat e montuara nuk ofrojnë fare incizim të zërit edhe pse në specifika teknike është kërkuar. Kjo mangësi mund të ndikojë edhe në çmimin e ofruar, pasi një kamerë që incizon edhe zërin do të kushtonte më shtrenjtë.

Për t'i kontrolluar kamerat nevojitet një NVR (Network Video Recorder). Kompania fituese ka ofruar modelin DS-7732NXI-I4S⁸. Edhe kjo pajisje nuk përputhet me të gjitha specifikat e kërkuar në dosje të tenderit. Është kërkuar që NVR të ketë minimum tetë SATA porte për të instaluar harddisqet, mirëpo pajisja i ka vetëm katër porte.

Është kërkuar që të ketë së paku katër USB porte, por pajisja i ka vetëm tri porte. Komuna në dy vende në paramasë ka përmendur produkte me emër (Intel Core dhe Seagate), gjë që është e ndaluar me LPP⁹, mirëpo një gjë e tillë është e lejuar vetëm nëse shtohet edhe fjala "ekuivalente" në fund.

Kushtet e veçanta të dosjes së tenderit nuk janë kërkuar me rastin e publikimit të tenderit, por janë specifikuar vetëm pasi është nënshkruar kontrata. Ky veprim bie ndesh me RrUOPP-në¹⁰, i cili thotë që këto kushte duhet që të përgatiten së bashku me dosjen e tenderit. Mos specifikimi i tyre mund të shpie në situatë ku disa operatorë ekonomik të jenë në avantazh nëse i dinë kushtet paraprakisht. Në këto kushte specifikohet garancioni për produktet, i cili ndikon në çmimin që do ta ofrojë operatori ekonomik. Në rastin e Komunës së Shtimes, veprim pozitiv është kërkesa për garancionin prej 12 muajsh, pasi në të kaluarën D+ ka hasur shpesh në tenderë ku nuk kërkohet fare garancion. Veprim tjetër i mirë është që afati për fillim dhe përfundim të kontratës është dhënë me datë fikse, pasi në shumë tenderë kërkohet vetëm përfundimi i kontratës me ditë.

Shkelja më e madhe në këtë tender është kërkesa që kamerat të incizojnë zërin, derisa kompania fituese ka ofruar vetëm incizim të videos. Pasi komuna nuk ka kërkuar në dosje të tenderit që kompanitë të tregojnë se me çfarë kamera do të ofertonin, është e pamundur të dihet se çfarë kamera do të kishin ofruar operatorët tjerë ekonomik që nuk janë shpallë fitues. Megjithatë, komuna do të duhej ta vendoste në dosje të tenderit një kërkesë që OE-të të dorëzojnë katalog për produktet që do të ofronin, pasi në atë rast komuna do ta dinte paraprakisht se çfarë produkti do të blinte.

8 Faqja e modelit të NVR DS-7732NXI-I4S nga Hikvision

<https://www.hikvision.com/en/products/IP-Products/Network-Video-Recorders/Pro-Series/DS-7732NXI-I4S/>

9 Ligji për Prokurim Publik. Neni 28.7. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. 2016.

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>

10 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik. Neni 18.3. Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik. 2019

[https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/A01 2019/Rregullat dhe Udhhezusi 10 04 2019 2.pdf](https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/A01%202019/Rregullat%20dhe%20Udhhezusi%2010%2004%202019%202.pdf)

Riparimi i dy urave dhe rregullimi i shtratit të lumit 617-19-5848-5-2-1

Tenderi për riparimin e dy urave, në fakt është tender për riparimin e një ure dhe prishjen dhe ndërtimin e një ure tjetër. Ky tender është ritenderim, pasi tenderi i parë ishte anuluar meqë kompania e rekomanduar për kontratë nuk e kishte dorëzuar sigurinë e tenderit sipas kërkesës. Në tenderin e dytë fitues ishte përzgjedhur kompania NTP Ardhmëria, me çmim 45,320.50 euro. Kjo kompani kishte ofertuar edhe në tenderin e parë, por me çmim më të lartë, me 48,736 euro. Në të dy tenderët vetëm NTP Ardhmëria kishte ofertuar. Kërkesat e dosjes së tenderit nuk ishin kufizuese ndaj konkurrencës, ndërsa mosinteresimi i kompanive tjera për të ofertuar mund të shpjegohet ndoshta nga vlera e ulët e tenderit. Megjithatë kërkesat në dosje të tenderit nuk janë pa mangësi: janë kërkuar dy kamionë të rëndë dhe dy eskavatorë, por pa specifikuar peshën e këtyre pajisjeve. Praktika që përdoret nga autoritetet tjera kontraktuese është që për këto pajisje gjithmonë caktohet pesha.

Gjetje tjetër është se komuna nuk e ka publikuar fare projektin ekzekutiv të urave, e cila është e obligueshme sipas RrUOPP.

20.13 Projekti Ekzekutues është një dizajn grafik i të gjitha proceseve administrative dhe inxhinjrike të punimeve të kërkuara siç është përshkruar në Specifikat Teknike dhe prandaj, parashtro, në raste të veçanta, punime arkitektonike, strukturore të punëve që do të ekzekutohen. Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e Projektit Ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet ti bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.

Mospublikimi i projektit ekzekutiv së bashku me dosjen e tenderit, krijon rrezik që të ketë trajtim jo të barabartë ndërmjet operatorëve ekonomik dhe eliminim të konkurrencës së drejtë, pasi një OE mundet përmes kanaleve jozyrtare të marrë projektin ekzekutiv. Kjo do të krijonte avantazh për atë OE, i cili mund ta ndërtojë ofertën e tij në bazë të këtij projekti. Nga ana tjetër, kompanitë tjera që nuk kanë mundësi ta marrin projektin ekzekutiv përmes këtyre kanaleve do të ishin në disavantazh pasi do ta kishin të vështirë të ofertojnë me çmime konkurruese.

Nga titulli i tenderit mund të shihet që është kërkuar edhe rregullimi i shtratit të lumit, mirëpo në paramasë nuk ka asnjë pozicion ku parashihet një gjë e tillë. E gjithë vlera e kontratës është shpenzuar për të rregulluar urat, por titulli i tenderit dhe përshkrimi i punëve të dhëna në njoftimin për kontratë flasin për riparim të urave dhe rregullim të shtratit të lumit. Vlera e parashikuar për këtë tender ishte 50,000 euro dhe duke marrë parasysh këtë vlerë nuk mund të dihet a është paraparë edhe rregullimi i shtratit të lumit apo vetëm riparimi i urave.

Gjatë zbatimit të kontratës, në një nga pozicionet kompania nuk e ka kryer punën siç duhet, përkatësisht në pozicionin 2.3 të paramasës:

2.3 Furnizimi dhe punimi i ngjyrës së Asfaltit e cila duhet të jetë rezistente ndaj kushteve atmosferike dhe abrazionit. Ngjyrën e cakton organi mbikëqyrës.

Kompania, asfaltin mbi urë e ka punuar me ngjyrë të kuqe, e cila pas disa ditëve është shlyer pothuajse e tëra¹¹, e ku deri më 31 janar 2020 nuk ka qenë e rregulluar. Për këtë pozicion kompania ka dhënë çmim prej 2,000 euro. Ky pozicion krahasuar me ato të tjerat nuk ka ndonjë specifikim teknik për parametrat e ngjyrës dhe elemente tjera. Nga të dhënat nuk mund të dihet sa kushton kjo ngjyrë në treg, ndërsa kompania ka mundur të ketë dhënë çmim shumë të lartë.

Komuna duhet të sigurohet që në të ardhmen, tenderët që kanë të bëjnë me ekzekutim të punëve, të përmbajnë projektin ekzekutiv, si dhe të sigurohet që titulli i tenderit dhe qëllimi i projektit të përputhen me pozicionet në paramasë.

Komuna e Obiliqit

Komuna e Obiliqit krahasuar me komunat tjera qëndron më mirë sa i përket kriterëve në dosje të tenderit dhe parashikimit të vlerës së tenderit. Gjithashtu edhe kushtet e veçanta të dosjes së tenderit përcaktohen në fillim, para se të dorëzohen ofertat.

Tenderi për furnizim me lëndë djegëse është një shembull i mirë i përgatitjes së dosjes në mënyrë të duhur, si dhe parashikimit të duhur të buxhetit, ku i ka mundësuar komunës të nënshkruajë kontratë shumë më lirë se Komuna e Kamenicës.

Në tenderin për sigurim fizik, komuna edhe pse ka parashikuar buxhet të mjaftueshëm i cili i përfshin të gjitha shpenzimet, nuk ka llogaritur pragun nën të cilin ofertat e kompanive nuk do të mbulonin shpenzimet, ku ka përzgjedhur fitues kompaninë e cila ka ofertën për 866 euro më të ulët se kostoja. Rreziku në këtë rast është që kostoja të bartet te punëtorët, p.sh: mospagimi i ndonjë pjese nga kontributi pensional.

Furnizim me lëndë djegëse për ngrohje 614-19-6415-1-2-1

Tenderi për furnizim me lëndë djegëse për ngrohje përfshin furnizimin me dru dhe pelet. Specifikat për furnizim me dru janë të njëjta me ato të Komunës së Kamenicës, dru ahu dhe sharritja e tyre. Në këtë tender fitues i kontratës ishte përzgjedhur NTP Agoniti me çmim 65,583.10 euro, i cili gjithashtu ishte me çmimin më të ulët, ndërsa dy oferta tjera ishin të papërgjegjshme, ndërsa dy të tjera të përgjegjshme, por me çmim më të lartë. Çmimi për një metër kub dru, prej 31.70 euro është dukshëm më i ulët se çmimi në kontratën e Komunës së Kamenicës. Në fakt të gjitha ofertat në këtë tender kanë çmim më të ulët se fituesi i kontratës në Komunën e Kamenicës. Kjo ka ndodhur për shkak se, Komuna e Obiliqit për 1,993 metër kub dru dhe 16 ton pelet ka parashikuar vlerën 73,005 euro. Nëse supozojmë që një ton pelet është parashikuar të kushtojë 200 euro, atëherë 13 tonë bëjnë 2,600 euro, ndërsa pjesa e mbetur prej 70,405 euro mbetet për dru. Vlera e parashikuar për një metër kub dru do të ishte 35.33 euro, e cila është dukshëm më e ulët sesa në Komunën e Kamenicës (46.7 euro m3).

Krahasuar me vitin 2018, në tenderin e atij viti komuna ka blerë dru me çmim 32 euro për metër kub, ndërsa në vitin 2019 i ka blerë për 30 cent më lirë. Kjo tregon se tenderi i vitit 2019 nuk ka qenë ndonjë rast i veçantë, por nëse planifikohet buxheti mirë, drutë mund të blihen me çmim rreth 32 euro për metër kub.

¹¹ Urës së Shtimës i del ngjyra dy ditë pasi u rregullua. Buletini Ekonomik. 2019. Qasur më 20.01.2020 <http://buletiniekonomik.com/index.php/2019/12/10/ures-se-shtimes-i-del-ngjyra-dy-dite-pasi-u-rregullua/?fbclid=IwAR0Nx0hVPMFzanaK4InvUyUr7oAqXxjmNHfNHZJAqwcYXwmutmQ-D1z4CkM>

Kriteret e dosjes së tenderit kanë pasur mundësi të jenë më pak të ashpra, pasi te qarkullimi financiar është kërkuar dyfishi i vlerës së parashikuar. Kjo gjë është e lejuar me LPP-në, por meqë është bërë fjalë për një produkt të thjeshtë siç janë drutë nuk do të kishte ndonjë rrezik po të kërkohej më pak, derisa edhe numri i ofertave do të ishte më i madh. Për dallim nga komunat tjera, kushtet e veçanta janë të përfshira së bashku me dosjen e tenderit, mirëpo në kontratë janë ndryshuar disa prej tyre, gjë e cila nuk do të duhej të ndodhte, pasi ato duhet të jenë identike.

Blerja e druve me çmim 31.70 euro për metër kub, tregon se Komuna e Obiliqit e ka parashikuar mirë se sa mund të kushtojë një metër kub dru në treg, kur bëhet fjalë për sasi të mëdha, pasi për pak dru, çmimi në treg mund të jetë më i lartë. Komuna duhet të vazhdojë edhe në tenderët e viteve të ardhshme të llogarisë vlerën e parashikuar ashtu si në vitet paraprake, e përderisa ka mbi pesë oferta në një tender, atëherë nënkuptohet që kompanitë mund ta bëjnë furnizimin edhe me çmim nën 35 euro për metër kub.

Sigurimi fizik i objektit komunal 614-19-149-2-2-1

Tenderi për sigurim fizik është publikuar në fillim të vitit 2019, mirëpo për shkak të ankesave në OShP, kontrata nuk është nënshkruar deri në korrik të 2019-së. Fitues i kontratës ishte shpallur kompania Rosa Security, me çmim 25,344 euro për një periudhë prej 36 muajsh. Meqë, kontrata është kontratë kornizë, lejohet që të ketë devijim +-30%. Në këtë tender ofertuan 12 kompani, ndërsa nëntë ishin të papërgjegjshme, ku shtatë prej tyre ishin eliminuar për shkak të sigurimit të tenderit, të cilin nuk e kishin dorëzuar sipas kërkesës. Dy kompani tjera edhe pse të përgjegjshme, kanë ofertuar me çmim më të lartë se Rosa Security.

Në vlerësimin e parë të ofertave, komuna kishte rekomanduar për fitues Rosa Security, por procesi ishte pezulluar, pasi në OShP ishte ankuar kompania International Security Association, me pretendimin që oferta e Rosa Security nuk arrin t'i mbulojë të gjitha shpenzimet që rrjedhin nga Ligji i Punës. OShP aprovoi ankesën dhe ktheu tenderin për t'u rivlerësuar¹². Pas rivlerësimit, përsëri për kontratë ishte rekomanduar Rosa Security, vendimi i cili shtyri International Security Association që të ankohet përsëri në OShP. Herën e dytë, OShP kishte vendosur që ta aprovojë vendimin e komunës për dhënie të kontratës, me arsyetimin se Rosa Security i plotëson të gjitha kriteret sipas Ligjit të Punës dhe është oferta më e lirë¹³.

Në tenderët për sigurimin fizik, element kryesor i cili përbën shpesh 100% të koston, janë pagat e punëtorëve. Komuna e Obiliqit ka kërkuar në dosje të tenderit që të respektohet Ligji i Punës, si dhe të llogariten të gjitha taksat e aplikueshme, ndërsa paga neto të jetë 270 euro në muaj. Në dosje të tenderit janë kërkuar dy punëtorë për të punuar tetë orë në ditë, pesë ditë në javë për 36 muaj. Shpenzimet e ofertës për një punëtorë janë paga neto + tatimi në pagë + kontributi pensional i punëtorit + kontributi pensional i kompanisë + TVSh prej 18%. Shpenzimi për një punëtor për një muaj do të ishte:

$(270 + 9.13 + 14.69 + 14.69) * 1.18 = 364.04$ euro, ndërsa për dy punëtorë është 728.08 euro, ndërsa për 36 muaj 26,210.88 euro.

Oferta e Rosa Security ishte 25,344 euro dhe nga krahasimi me çmimin më lartë mund të vërehet që oferta është në kosto, ndërsa dallimi është 866.88 euro. OShP në analizën që i kishte bërë ofertës financiare nuk ka përfshirë në llogaritje kontributin pensional të punëtorit (për një punëtor, 14.69 euro, për dy 29.38 euro), gjë e cila shprehimisht ishte

¹² Vendimi 106/19. Organi Shqyrtues i Prokurimit. 2019.

<http://arkivaoshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2019/106-19vend.pdf>

¹³ Vendimi 298/19. Organi Shqyrtues i Prokurimit. 2019.

<http://arkivaoshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2019/298-19vendim.pdf>

kërkuar në dosje të tenderit. OShP kishte ardhur në përfundim se, kontributin pensional punëtori e paguan vetë, mirëpo është konstatim i gabuar, pasi në këtë rast është kërkuar paga neto e jo bruto. Me fjalë të tjera, kur kërkohet paga neto, punëtori nuk paguan kontribut pensional, por këtë obligim e kryen kompania. Se nuk është përfshirë e gjithë kostoja në ofertë mund të vërehet edhe nga paramasa e tenderit, ku çmimi është kërkuar të jepet për orë pune, ndërsa Rosa Security ka dhënë çmim dy euro për orë përfshirë të gjitha taksat. Në paramasë, për një muaj, për dy punëtorë janë dhënë 352 euro apo 176 për një punëtor. Nga shpenzimi për një punëtor për një muaj që ishte 364.04 euro mund të llogaritet sa është kosto për një orë për një punëtor:

$$364.04 / 176 = 2.0684 \text{ euro}$$

Nga llogaritja më lart vërehet se kosto për një orë është rreth shtatë cent më e lartë se oferta e kompanisë. Kur të llogaritet për dy punëtorë, për 36 muaj rezultati është:

$$176 * 2 * 36 * 0.0684 = 866.76 \text{ euro}$$

Nga llogaritja prej vlerave të dhëna në paramasë (866.76 euro) dhe llogaritjes së bërë nga të dhënat e vendimit të OShP-së (866.88 euro), shihet se vlerat janë të njëjta (dallimi shumë i vogël për shkak të rrumbullakimeve në dy numra pas presjes dhjetore), me ç'rast është konfirmuar që oferta e Rosa Security nuk i përfshin të gjitha shpenzimet.

Kriteret në dosje të tenderit, ashtu si në atë për furnizim me dru nuk kanë elemente kufizuese, ndërsa kushtet e veçanta janë specifikuar së bashku me dosje. Gjithashtu, komuna ka vepruar drejt kur ka cekur të gjitha elementet e Ligjit të Punës dhe ka kërkuar nga ofertuesit që t'i nënshkruajnë deklaratat që do t'u përmbahen të gjitha kërkesave, pra përfshirjen e pagës neto së bashku me detyrimet tjera dhe TVSh-në. Shqetësues mbetet fakti se, po vazhdohet me avazin e gabimeve në llogaritje të kostos, si nga autoritet kontraktuese ashtu edhe nga OShP-ja. Në tenderët për sigurim fizik është pikërisht llogaritja e kostos së ofertës që përcakton edhe fituesin. Në këtë rast, po të llogaritej saktë shpenzimi për një orë dhe për tërësinë e orëve për 36 muaj, atëherë do të dihej pragu nën të cilat ofertat nuk do të mund t'i mbulonin shpenzimet e tyre. Së pari duhet të dihet pragu, pastaj të zgjidhet oferta e përgjegjshme me çmimin më të ulët. Në këtë rast, çmimi më i lirë ka rënë në kundërshtim me koston e krijuar dhe Rosa Security me çmimin e ofruar nuk do të mund ta paguajë kontributin pensional të punëtorit.

Rekomandime

Për të gjitha komunat:

- T'i jepet rëndësi më e madhe përcaktimit të vlerës së parashikuar të tenderit, në mënyrë që të kursehet buxheti. Krahasimi i çmimeve me një periudhë paraprake apo me çmimet e kontratave të autoriteteve tjera kontraktuese janë bazë e mirë ku mund të fillohet përcaktimi i vlerës së parashikuar.

Për Komunën e Shtimes:

- Specifikat teknike për produkte të teknologjisë informative të jenë më pak të ngarkuara;
- Katalogu i produktit me të cilin oferton operatori ekonomik të vendoset si kërkesënë dosje të tenderit.

Për Komunën e Podujevës:

- Të sigurohet që kushtet e veçanta specifikohen së bashku me publikimin e dosjes së tenderit, në mënyrë që ofertuesit të përgatisin ofertat e tyre sipas këtyre kushteve;
- Në kontratën e nënshkruar të përfshihet edhe lista e çmimeve, pasi përveç që kërkohet me ligj u ndihmon palëve të interesuara që të dinë se çfarë çmime po paguan komuna për punë apo shërbime të caktuara.

Për Komunën e Kamenicës:

- T'i kushtohet vëmendje më e madhe llogaritjes së vlerës së parashikuar të tenderit. Kjo gjë është akoma më e lehtë kur bëhet fjalë vetëm për një produkt, siç është tenderi për furnizim me dru;
- Të sigurohet që në tenderin për servisim të veturave nuk do të ketë faturim vetëm të pjesëve ku është dhënë çmim i lartë. Gjithashtu, të porositen riparime sidomos për pjesët ku janë dhënë çmime jonormalisht të ulëta.

Për Komunën e Obiliqit

- Për tenderët e ardhshëm të sigurimit fizik, të llogaritet së pari pragu nën të cilin ofertat do të ishin të papërgjegjshme, pasi sipas matematikave nuk mund t'i mbulojnë shpenzimet. Por, për ta bërë këtë duhet që të ketë persona me njohuri adekuate në komisionin e vlerësimit.

Për Komunën e Fushë Kosovës

- T'i përgjigjet kërkesave për qasje në dokumente publike sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike;
- Të sigurohet që specifikat teknike nuk u përshtaten markave tregtare dhe prodhuesve të caktuar;
- Para se të publikojë një tender, të konsultohen me çmimet e tregut dhe me çmimet e kontratave paraprake, kjo për t'i evituar humbjet në buxhet si pasojë e çmimeve të larta.

Demokrasi Plus

Demokrasi Plus (D+) është një organizatë e pavarur dhe jofitimprurëse e themeluar në mars të vitit 2016. D+ është e përkushtuar për krijimin e një shoqërie demokratike përmes rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në procese politike, rritjes së llogaridhënies dhe ndikimi në proceset e vendimmarrjes. Ne tentojmë integrimin e teknologjisë informative në të gjitha përpjekjet tona, kjo për të nxitur përdorimin e internetit, i cili ka rol të rëndësishëm në demokratizimin e një shoqërie.

D+ synon që të kontribuojë në krijimin e praktikave të mira për qeverisje të mirë nga institucionet publike në nivel qendror dhe lokal, fuqizimin e sundimit të ligjit, avancimin e partive politike, si dhe përkrahjen e proceseve të lira dhe të drejta zgjedhore.

Përkrahur nga:

